



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë e Huaj B për qëllime specifike

Ngarkesa: 4 kredite; 60orë mësimore; .30 leksione / .30 seminare
Viti / Semestri: Viti II , semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhë Angleze”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të pajisë studentët e programit Master me njohuri teorike bazë për mësimdhënien e gjuhës angleze për qëllime specifike, në varësi të kontekstit profesional. Të krijojë një kuptim të gjerë mbi rolin e ESP-së në lidhje me disiplina të tjera si psikologjia, sociolinguistika, psikolinguistika dhe shkencat e edukimit. Të nxisë reflektimin dhe zhvillimin profesional të studentëve në raport me rolin e tyre si mësues të gjuhës për qëllime specifike.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të njohë studentët me zhvillimin historik të ESP-së dhe me dallimin ndërmjet metodave diakronike dhe sinkronike në këtë disiplinë.
2. Të aftësojë studentët për të kuptuar dhe zbatuar kompetencat komunikuese në një kontekst profesional të veçantë.
3. Të analizojnë qasjet aktuale në mësimdhënien e gjuhës së huaj për qëllime specifike dhe të identifikojnë teknikat më të përshtatshme për nevojat e nxënësve.
4. Të zhvillojnë aftësi për të përshtatur mësimdhënien me natyrën dhe kërkesat e disiplinave si drejtësia, ekonomia, mjekësia, inxhinieria etj.

Rezultatet pritshme:

Në përfundim të lëndës, studenti duhet të jetë në gjendje të:

1. Shpjegojë konceptet bazë teorike të ESP-së dhe marrëdhënien e saj me disiplina të tjera akademike dhe profesionale.
2. Identifikojë nevojat specifike të nxënësve në mjedise të ndryshme profesionale dhe të përshtatë përmbajtjen gjuhësore sipas këtyre nevojave.
3. Zbatojë metoda dhe teknika bashkëkohore për të ndërtuar orë efektive mësimore të ESP-së.